

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,** Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.(I.) H. nga fshati B., Komuna e P., për shkak se në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhje e pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzave: PP.nr.7812-8/2011 e dt. 15.06.2012, PP.II.nr.3704/13 e dt. 04.07.2013, PP.nr.19/2015 e dt. 20.02.2015, PP.nr.8392/2014 e dt. 26.02.2015, PP.II.nr.3616/14 e dt. 03.07.2015, PP/II.nr.4405/15 e dt. 03.09.2015, PP.II.nr.3810/15 e dt. 23.09.2015, PP/II.nr.5847/15 e dt. 04.12.2015, PP.II.nr.4412/15 e dt.14.12.2015, PP.II.nr.7678/14 e dt. 02.04.2015, PP/II.nr.8380/14 e dt.12.12.2014, PP.nr.1320/15 e dt.16.03.2015 dhe PP/II.nr.6423/14 e dt.10.07.2015, PP.II.nr.7661/14 dt. 23.10.2015, PP.II.nr.1337/15 e dt. 21.05.2015, PP.II.nr.1293/15 e dt. 12.01.2016, PP.nr.3797-5/2010 e dt. 13.12.2010, të PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 25.04.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Fatmir Behrami dhe të akuzuarit, me datë 27.05.2016, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 13.05.2016 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari,

**N. H., me nofkën N.,** i biri i I., dhe nënës S. e vajzërisë I., i lindur më dt. *data e lindjes...*, në fshatin M., tani me vendbanim në fshatin B., Komuna e P., me nr. personal të identifikimit *numër personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i 3 (tre) fëmijëve, ka qenë i gjykuar edhe më parë për vepra të njëjta penale, ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera për vepra të njëjta penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### S e p s e:

Me dt. 22.06.2010, rreth orës 14:00, në pyllin me të cilin qeverisë Agjencion i Pyjor i Kosovës, zyra në Prishtinë, në vendin e quajtur “Përroi i Shitaricës” Regjioni Ekonomiko-Pyjor i Murgullës, KK Podujevë, me sharrë motorike, me traktor dhe ram, ka prerë dhe marrë 9 copë dru ahu, me gjatësi 22m, me diametër 41-51cm, me vëllim të përgjithshëm, 11.16m<sup>3</sup>, me ç’rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës, i është shkaktuar dëm material.

Me dt.17.10.2011,rreth orës 18:00,i pandehuri me qëllim vjedhje, në vendin e quajtur “Prroni i Gërdocit” në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të Murgullës, Komuna e Podujevës, me të cilin qeverisë Autoritetit Pyjor zyra në Prishtinë, me sharrë motorike, traktor dhe ram, ka prerë 9 copë trungje të llojit Ahu, me gjatësi 18m,diametër 30-45cm, dhe vëllim të përgjithshëm 6.36m<sup>3</sup>,me ç`rast Autoritetit Pyjor i Kosovës-zyra në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 27.04.2013, rreth orës 15:30, në pyllin publik të quajtur "Osoja e Halilit" në regjionin ekonomikopyjor M.Bellanicës KK Podujevë, me të cilin menaxhon Drejtoria e Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm është zënë në flagrancë nga roja i pyllit duke prerë 10 copë trungje të llojit ahu, me sharrë motorike, dhe traktor, me dimensione 18metra, diametër 35-65cm, me vëllim të përgjithshëm 7,76m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Më datën 31.03.2014, rreth orës 13:50, në pyllin në pronësi publike në vendin e quajtur te "Përroi i Bjeshkës " Regjioni Ekonomiko- pyjor i Turuqicës, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë, duke prerë dru dhe atë 12 copë trungje të llojit ahu, me dimensione të gjata 14m, me diametër 37cm, me vëllim të përgjithshëm 5.28 m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Agjencisë Pyjore të Kosovës i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 13.07.2014, rreth orës 12:00, në vendin e quajtur "Rovinat-Bellosicë", në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të Tërrenavicës, Komuna e Podujevës, në pyllin në pronësi publike me të cilin menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, është zënë nga roja e pyllit duke prerë dru zjarri dhe atë 7 copë trungje të llojit Ahu, me diametër 45-46cm, me gjatësi 16 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 5-65m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 14.08.2014, rreth orës 18:00, në vendin e quajtur "Rovinat", Regjioni i Ekonomisë Pyjore të "Tërrenavicës" Komuna e Podujevës, me qëllim që vetës t' i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, është zënë duke prerë trungje dhe atë 9 copë trungje të llojit "Ahu", me dimensione, gjatësi 16m, me diametër 39-41cm, me vëllim të përgjithshëm prej 5.38m<sup>3</sup>, duke i shkaktuar të dëmtuarës Ekonomisë Pyjore të "Tërrenavicës" i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 18.09.2014, rreth orës 18:00, me qëllim të vjedhjes në pyll, me të cilin qeverisë Regjioni Ekonomiko Pyjor i Murgullës, në vendin e quajtur "Shitaricë", i pandehuri ka prerë 8 copë dru të llojit ahu, me gjatësi 16m, me diametër 25-49cm, me vëllim të përgjithshëm prej 4.90m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë, i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

Me datën 29.09.2014, rreth orës 17:00, në vendin e quajtur "Te Vullakët" në pyllin me të cilin qeverisë Drejtoria e Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural, regjioni ekonomikopyjor në Murgull, i pandehuri N.H. me qëllim të përvetësimit të pasurisë në mënyrë të paligjshme ka prerë 26 copë trungje, me sharrë motorike, të llojit ahu, me dimensione të gjata 14metra, me diametër 28-30cm, me vëllim të përgjithshëm prej 12,68m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 30.09.2014, rreth orës 14:40, në vendin e quajtur "Gërdeq" e cila gjendet në Murgull, Komuna e Podujevës dhe e cila është në pronësi publike me të cilin menaxhon e dëmtuara Agjencioni Pyjor i Kosovës nga Podujeva, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm ka prerë dru, të llojit Ahu, në sasi prej 10,95m<sup>3</sup>, ku në vend të ngjarjes është vërejtur dhe kapur nga ana e rojtarit të pyllit, me ç'rast të dëmtuarës Agjencioni Pyjor i Kosovës nga Podujeva i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 20.10.2014, rreth orës 15:00, në vendin e quajtur "Osoja e Halilit" e cila gjendet në Murgull, Komuna e Podujevës dhe e cila është nën mbrojtje të posaçme e me të cilën menaxhon

e dëmtuara Agjensioni Pyjor i Kosovës nga Podujeva, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm ka prerë dru, të llojit ahu, në sasi prej 11,88m<sup>3</sup>, ku në vend të ngjarjes është vërejtur dhe kapur nga ana e rojtarit të pyllit, me ç'rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës nga Podujeva i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 03.11.2014, rreth orës 13:30, me qëllim të vjedhjes në pyll, me të cilin qeverisë Regjioni Ekonomiko Pyjor i Murgullës, në vendin e quajtur "Osoja e Halilit, i pandehuri ka prerë 6 copë dru të llojit ahu, me gjatësi 16-19m, me diametër 52-60cm, me vëllim të përgjithshëm prej 8.40m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë, i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

Me datën 10.11.2014, rreth orës 12:00, në vendin e quajtur "Bejnuz" e cila gjendet në Tërrenvicë, Komuna e Podujevës, me të cilin menaxhon e dëmtuara Agjensioni Pyjor i Kosovës nga Podujeva, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka prerë dru të llojit ahu, në sasi prej 7,05m<sup>3</sup>, ku në vend të ngjarjes është vërejtur dhe kapur nga ana e rojtarit të pyllit, me ç'rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës nga Podujeva i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 29.01.2015, rreth orës 12:00, në vendin e quajtur "Osoja e Halilit, në Regjionin Ekonomiko –Pyjor të Murgullës KK Podujevë, në pronësi publike, i pandehuri është takuar duke prerë dru zjarri me sharrë motorike pa leje me qëllim vjedhje dhe atë 6 copë trungje të llojit ahu me dimensione të gjata 19-20m, me diametër 58-62cm, me vëllim të përgjithshëm prej 11-26m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Sektorit të Pylltarisë në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 07.06.2015, rreth orës 12:00, në vendin e quajtur "Gërdeq" në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të Murgullës, Komuna e Podujevës, në pyllin në pronësi publike të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t' i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga rojet e pyllit, duke prerë dru dhe atë 18 trungje të llojit ahu, me diametër 37-42cm, me gjatësi 16 metra, me vëllim të përgjithshëm 10.70m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Komunën e Podujevës i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 15.06.2015, rreth orës 20:00, me qëllim të vjedhjes, në pyllin me të cilin qeverisë Komuna e Podujevës, në vendin e quajtur "Gërdeq" Regjioni Ekonomiko-Pyjor i Murgullës, Komuna e Podujevës, ka prerë 18 copë trungje të llojit Ahu, të gjata 16m, me diametër 35-49cm, dhe me vëllim prej 8.72m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 23.06.2015, rreth orës 12:45, me qëllim për të vjedhur ka shkuar në pyll në vendin e quajtur "Bejnuz" në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të Tërrenvicës, Komuna Podujevë, me të cilin qeverisë Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Pylltarisë, ku aty ka prerë 5 copë trungje të llojit ahu, me diametër 40-63cm, me gjatësi prej 16m, me vëllim të përgjithshëm 5,25m<sup>3</sup>, me ç'rast të dëmtuarës Komuna e Podujevë, Sektori i Pylltarisë i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 02.09.2015, rreth orës 17:00, në vendin e quajtur "Gërdeq" në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të Murgullës, KK Podujevë, në pyllin në pronësi publike me të cilin menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, është zënë nga roja e pyllit në pyllin në pronësi publike duke prerë dru zjarri dhe atë trungje të llojit ahu, me diametër 49-53,cm, me gjatësi

18metra, me vëllim të përgjithshëm prej 19.99 m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Komuna e Podujevës i ka shkaktuar dëm material.

Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,43,45,73, nenit 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 450, 453, 463, të KPPRK-së, e

## G J Y K O N

Të akuzuarin **N. (I) H.**, me **dënim me burg** në kohëzgjatje **prej 5 (pesë) muaj**, të cilin do ta mbajë pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **500 € (pesëqind euro)**, të cilën obligohet ta paguaj në këste mujore në afat prej 3 (tre) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë në këste mujore në afat prej 3 (tre) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t`ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzetë euro), të papaguara do t`i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale- paushalle të paguajë shumën prej **50€** (pesëdhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Agjensionin Pyjor i Kosovës zyra në Podujevë për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

## A r s y e t i m

PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit Aktakuzat: PP.nr.7812-8/2011 e dt. 15.06.2012, PP.II.nr.3704/13 e dt. 04.07.2013, PP.nr.19/2015 e dt. 20.02.2015, PP.nr.8392/2014 e dt. 26.02.2015, PP.II.nr.3616/14 e dt. 03.07.2015, PP/II.nr.4405/15 e dt. 03.09.2015, PP.II.nr.3810/15 e dt. 23.09.2015, PP/II.nr.5847/15 e dt. 04.12.2015, PP.II.nr.4412/15 e dt. 14.12.2015, PP.II.nr.7678/14 e dt. 02.04.2015, PP/II.nr.8380/14 e dt. 12.12.2014, PP.nr.1320/15 e dt. 16.03.2015, PP/II.nr.6423/14 e dt. 10.07.2015, PP.II.nr.7661/14 e dt. 23.10.2015, PP.II.nr.1337/15 e dt. 21.05.2015, PP.II.nr.1293/15 e dt. 12.01.2016 dhe PP.nr.3797-5/2010 e dt. 13.12.2010, kundër të akuzuarit N. (I) H. nga fshati B., Komuna e P., për shkak të veprave penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Lidhur me këto çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 25.04.2016 në praninë e Prokurorit të Shtetit Fatmir Behrami dhe të akuzuarit N. H..

Gjykata paraprkisht ka verifikuar të kaluarën kriminale për të akuzuarin e lartcekur dhe duke pasur parasysh parimin e ekonomizimit dhe të efikasitetit të procedurës penale, me pajtimin e palëve respektivisht të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit, bazuar në nenin 35 par.8 të KPPRK-së, mori aktvendim që të bashkohet procedura penale dhe të zbatohet procedurë unike kundër të

akuzuarit N. H. për lëndët: Pka.nr.490/12, P.nr.655/13, P.nr.179/15, P.nr.180/15, P.nr.687/15, P.nr.862/15, P.nr.921/15 P.nr.,868/14, P.nr.884/14, P.nr.274/15, P.nr.757/15, P.nr.989/15, PP.nr.559/15, P.nr.30/16 ,P.nr.1244/15, dhe Pka nr.166/10 dhe tani e tutje procedura penale për këto lëndë do të mbaj numrin më të vjetër **P.ka.nr.166/10**.

Pas leximit të aktakuzave nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari N. H. deklaroi, e pranon fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzave, duke shtuar se kam prerë dru për shkak se jam i papunë, i gjendjes së rëndë ekonomike dhe nga të hollat që i realizoj nga shitja e druve e mbaj familjen, kërkoi nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi: Se pajtohem me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ngase është bërë konform nenit 248 të KPPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjeve që i përmbajnë aktakuzat në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit të pranuar nga ia akuzuari dhe aktakuzat nuk përmbajnë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë vullnetarisht, gjykata e vlerësoi dhe analizoi se pranimi i fajësisë ka mbështetje në prova që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, ka zbatuar ligjin më të favorshëm në kuptim të nenit 3 par.2 të KPRK-së, ashtu që beri rikualifikimin e veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, në veprë të njëjtë penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, si dhe ka konstatuar se i akuzuari në vazhdimësi ka kryer veprat penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, pasi që e dëmtuara është e njëjtë, objekti i veprës penale i njëjtë si dhe dashja e kryerësit të veprës penale, të parapara me nenin 81 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 të KPRK-së.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në vazhdimësi vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, nga se ka qenë i vetëdijshëm për veprimet tij dhe ka dashur kryerjen e veprës penale.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit lidhur me të akuzuarin N. H., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe se ishte korrekt gjatë shqyrtimit fillestar, i gjendjes së rëndë ekonomike, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti se i njëjti është recidivist, ka qenë i gjykuar me edhe më parë për vepra penale të njëjta, sipas aktgjykimeve dënuese me numra: P.nr.468/2011 të datës 05.02.2013, P.nr.787/2011 të datës 05.06.2013,

P.nr.806/2011 të datës 01.02.2013, P.nr.1440/2011 të datës 02.07.2015, dhe P.nr.271/2014 të datës 04.05.2015 të gjitha të formës së prerë, si dhe duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur që është prona publike, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilin dënim do ta mbaj pasi aktgjykim të merr formën e prerë.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, për shkak se gjykata nuk ka pasur ekspertizë nga ndonjë institucion i pavarur, në mënyrë që gjykata të vërtetojë saktësisht dëmin e shkaktuar, ashtu që dëmi i vlerësuar vetëm nga pala e dëmtuar nuk parqet bazë të sigurt për gjykim, andaj gjykata nuk e pranoj dhe mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**Pka.nr.166/2010,dt.13.05.2016**

**Sekretarja Juridike**  
Mihrie Krasniqi-Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.